



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 11.03.2025
Numër Protokolli: 2388/2025

A.nr.215/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari - kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtare, si dhe Ylber Fetahaj-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.215/2025 të datës 27.01.2025 të parashtruar nga ankuesi N.D., kundër organit të punësimit/Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, në çështjen juridike “*Kërkese nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr. 215/2025 e datës 27.01.2025 e parashtruar nga ankuesi N.D.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, N.D.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*) i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, me datë 27.01.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4551 të regjistruar nën shenjen A.nr.1326/2024 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për heshtje administrative dhe mos dhënies së përgjigjes ndaj kërkesës me Nr.Prt.6283 të datës 11.10.2024 të drejtuar ndaj Menaxhmentit të lartë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ndërsa me datë 18.02.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit duhet të hedhet poshtë si e palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të emërimit

të datës 23.07.2012 me shifër:1135 është i punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pozitën e punës: "Zyrtar për mostra" në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, ndërsa me datës 27.01.2025 ka parashtruar ankese në Këshill ndaj heshtjes administrative për mos dhënien e përgjigjes ndaj kërkesës së tij me Nr. Prot. 6283 të datës 11.10.2024 drejtuar Menaxhmentit të lartë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në pretendimet në ankese të ankuesit ku i njëjti pretendon se me datën 13.05.2024 rreth orës 8:30 ka pasur tentim sulmi fizik ndaj ti nga ana e U.D Shefit IKF I.M në zyrën e drejtoreshës së DI-së I.Z dhe në prezencën e saj ku është bërë ndërhyrja e saj për mos eskalim të situatës.

Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi përmes kërkesës me Nr.Prt.6283 të datës 11.10.2024 i është drejtuar Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, lidhur me ndërmarrjen e masave ndaj I.M, por i njëjti sipas shkresave të lëndës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim.

Ankuesi N.D., lidhur me mos ndërmarrjen e asnjë veprimi nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës është ankuar me pretendimet lidhur me mos ndërmarrjen e veprimeve nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës duke kërkuar nga ana e KPMSHCK që të bëjë zgjidhje në mosmarrëveshjet e tij me U.D Shefit IKF I.M, për shkak të fyerjes nga ana U.D Shefit IKF I.M

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës konkretisht në emalin e datës 04.12.2024 të Drejtorës së Drejtoratit të Inspektoratit znj. I.Z konstaton se e njëjta përmes këtij emali deklaron se citoj „Me datën 13.05.2024 në zyrën time ka pasur një mosmarrëveshje verbale me mesazhin e z. N. D. z. I.M., por nuk ka pasur sulm fizik. Pas kësaj situatë kam biseduar me dy zyrtaret, të cilët janë qartësuar dhe kanë filluar punën zyrtare pa problem. Nga kjo datë deri më sot nuk kam pasur asnjë informatë për ndonjë mosmarrëveshje në mes tyre”, andaj në rastin konkret Kolegji konstaton se meqenëse Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtorja e Drejtorisë së Inspektoratit si mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë nuk kanë ndërmarr veprime dhe meqenëse si rrjedhojë me mos marrjen e veprimeve nuk kanë konstatuar shkelje dhe nuk kanë gjetur që ka cenim të marrëdhënies së punës së ankuesit, e gjithashtu Kolegji në bazë të shkresave të lëndës nuk ka gjetur se ankuesit i është cenuar akt emërimi ose ndonjë e drejtë që buron nga marrëdhënia e punës në kuadër të shërbimit civil, rrjedhimisht Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit duhet të hedhet poshtë si e pa lejuar duke u nisur nga fakti se nga shkresat e lëndës pos që ka pasur një debat në mesë udhëheqësit të tij dhe ankuesit nuk është shkaktuar ndonjë pasojë edhe në fakt nuk është në kompetencën e Kolegjit që të detyroj një çështje të tillë, ankuesi për fyerje, kërcënime etj., mund të përdor procedurat gjyqësore si organe kompetente për këtë rast.

Theksuar si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë Juridike: *Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.215/2025

Ylber FETAHAJ

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesi N.D. ;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*